



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 23.02.2017 (E Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Arbëresha Ibrahim, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoj Baki Nebiu, Selvije Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integrime Evropiane, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë se Administrimit të Pushtetit Lokale, na ka konfirmu ligjshmërinë e akteve, gjithashtu me lejoni të ju njoftoj se Ministria e Tregtisë naj ka dhen pëlqimin për themelimin e zonës ekonomike respektivisht parkut indrustial ne fshatin Budrikë të Komuna e Vitisë. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtoj pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit! Kam kërkesë, ne fakt është një petecion nga disa fshatar të fshatit Skifteraj, ku më është adresuar me datën 22.02.2017. Ata kërkojnë që te behet hapja e kanalit qe lidhe nga cerneli e kalon afër familjes Zejnullahu dhe shkon tutje ne Budrikë. Ata janë anku që ka bë dëme edhe në këtë kohë në kulturat e tyre bujqësore,

si mister, grurë ky kanal rrezikon edhe disa familje që janë përreth. Ky eshët i vetmi kanal që ka met i pa hapur, e di që Kuvendi ka da një fond për hapjen e këtyre kanaleve, shpresoj që në agjenden e juaj të jete si prioritet. Ky është petecioni i nënshkruar i këtyre familjarëve, familja Zejnullahu, Zeneli, Ismajli, Haliti, Islami dhe Mustafa. Po ashtu me intereson ta di, ishte një ditë një foto lajme që kryetari ka bisedua një ditë me kryeministrin për kyqjen në autostradë, cili është epilogu i asaj.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit! Unë kam një kërkesë, që ne seancën e ardhshme ose me naj seancë të jashtëzakonshme, të jete pike e veçantë e rendit të ditës çështja e “Eko Higjienës”, kur po e dimë që po përballlet me disa probleme mjaft të mëdha në kohën e fundit. E shof që është edhe një vendim të “Eko Higjienës”, që kompania si kompani regjionale që ka qenë me herët me vendimi të 2008 me nr. 10/39, është njësi me 14.1%, aksionere e kompanisë. E dimë që kompania tash i ka marr te gjitha asetet i ka shit, e dimë edhe pse janë asete te gjitha donacione prej pesë kamionëve që kane bajt mbeturina, tash e kane vetëm një kamion, shumica e mjeteve janë shitë për hektra, unë mendoj që atje janë suspendu punëtorët, ka probleme të mëdha, mendoj që duhet të behet një raport, duhet t’i jepet një informatë, të behet një raporte duhet të kuptohet taman gjendja, nëse ka naj vendime të komunës të bihet, kërkoj që të jet pikë e veçantë e rendit të ditës për “Eko Higjienën”. Kam edhe një kërkesë, ku kërkoj që te na afrohet marrëveshja e memorandumit me Karitasin, që është për shëndetësi dhe ajo marrëveshje te afrohet dhe ta shohim se çka ka, se nuk e kemi pa, ti shofim edhe në kuadër të marrëveshjes të na ofrohet lista të cilët janë të punësuar që paguhet në këtë marrëveshje, se e dimë që edhe prej këshilltarëve komunal janë që paguhet nga ajo listë që është marrëveshje me emra. Është kanë e mirë që ne seance mu kanë edhe kryetari, e dimë që ne ditët e fundit jenë bë disa shkrime për një çmim që është marr i kryetarit, është mirë të jete këtu, të na sqaron, sepse e shofim që median edhe në Itali që e kane hulumtu disa raste që organizata e cila e ka nderu kryetarin, mesionar paqe, ka dhënë shpërblime fallco të shitura deri ne 7000 euro, mendoj që i njëjti person Shefki Hysa që e ka dhënë at shpërblim kryetarit, i njëjti i ka dhanë çmimin edhe “Doktor Honorizkauza” ne sallën e Kuvendit Komunal, që është i vemi rast në botë që ka marr çmim “Honorizkauza”. Është kryetari i komunës, unë mendoj që duhet t’i sqaroj para neve, t’i sqaroj ato vendime, në bazë cilave vendime i ka marr këto, cili universitet i ka dhënë çfarë vendime të senatit ka, kush i ka marr ato vendime dhe qysh janë dhënë këto çmime. Kanë shkru edhe gazetata tjerë, kemi bë edhe reagimin ne, mendoj që duhet të sqarohet kjo çështje.

z.Bislim Bislimi: Përshëndetje të nderuar! Në lidhjen me takimin që e keni pas me kryeministrin, është premtu që do ta bëjmë lidhjen e autostradës, çka u bë me këtë. Çështja tjetër është, komuna jone është me shume se 50% pyeje, për këto tri vite sa jemi ne këtu, çka është bë, a kemi punu diçka për këto pyeje, a kemi pasur mundësi me e hap ndonjë vend pune, me zhvillu ndonjë turizëm.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishme, do ta ngris një çështje që edhe me herët u ngrit nga dikush. Prej rrugës nga Smira deri të rruga e Drobeshit ditë e me shumë po hudhen betona aty, që po paraqesin rrezik për ngasësit e veturave, po u përplas ndonjë vetur aty veç vdekjen po thuaj e ka të garantume. Unë mendoj që Drejtoria e Inspeksionit së paku 5 metra duhet me i marr masat me i largu qato betona që janë afër rrugëve, e dimë qe janë privat, mirëpo ato mbeturina aty nuk duhet me i lënë asnjë ditë. Më herët kemi than me vendos një shej të komunikacionit, këtu të taksistët në Viti, sepse është pengesë edhe për taksist edhe për qytetar, nuk e di pse nuk u vendos ajo shenj. Në fshatin Goshicë është ndriku një pjesë e fshatit. Ka kërkesa të qytetarëve për mu ndriku edhe pjesët e tjera, mirëpo qajo pjesë që është ndriku, një pjese e tyre

nuk është tu funksionu, është mirë që kompania me majt përgjegjësi dhe me i rregullu ashtu siç kanë qenë.

z.Ekrem Abazi: Përsëendetje për të pranishmit! Edhe unë jam i shqetësuar me atë informatë apo dezinformatë, nëse është informatë është për me e njoftu opinionin me e njoftu qytetaret se ai çmim që e ka marr kryetari është diçka prej një njeri jo të mirë, po nëse është dezinformatë me e njoftu opinionin. Pasi që nuk është kryetari po kërkojnë prej nënkryetarit me naj bë një sqarim.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përsëendetje për ju të gjithë të pranishmit. Pyetje ishte një peticion. Unë mendoj që janë këshillat e fshatrave të cilët bëjnë kërkesat e nevojave për lokalitetet e veta, prandaj mendoj që janë mekanizmat që funksionojnë. Po te njoftoj, se dy kanalet të cilët shkojnë prej Budrikes në Skifteraj janë të hapura, ky të cilin po e shtron ti, e di edhe detalisht, se jam rrit aty, është një kanal i vogël, ndërsa dy kanalet paralel që e terjekin ujin me te madhe vitin e kaluar janë hapur. Pyetja tjetër ishte takimi i kryetarit me kryeministrin. Është bë bisedë nga personat që janë përgjegjës për atë çështje, tu fillu nga kryeministri, ministri i Infrastrukturës, kryetari i Komunës së Ferizajt, kryetari i Komunës së Vitisë, që ka dal si kërkesë kyqja në Gerlicë për qytetaret e Vitisë. Nga takimi i cili është zhvillu, është zot kryeministri, se ne rishikim të buxhetit do të bëhet e pamundshme që ti mundësohet edhe Vitisë ajo kyqje të realizohet, besoj që kjo punë do të kryhet. Bekimi shtroj dy çështje. Bekim, më mirë se unë e dinë a ka pasur apo nuk ka pasur vendime, se ka qenë nën udhëheqjen e subjektit tanë, partisë politike, kur e keni përplas “Eko Higjienën” ne partneritetin publiko private. A keni pas vendim a jo ti e dinë shumë mirë, që unë në bazë të hulumtimeve të mija nuk kame mujt me gjet që ka pas vendim. Gjendja nuk është e mirë, tash na kemi bë përpjekje maksimale, sidomos në njësitin tonë, që Vitinë ta pastrojmë. Mujmë me diskutu pikë të veçantë këtë, por ka diskutu edhe Kuvendi i Gjilanit, por nuk u dal, duhet një çështje tjetër, ku kryetari i komunës ka formuar një grup që duhet na paralelisht me pastru Vitin me qet gjendje që e kemi, ta formojmë një grup punues, i cili ne aspekt ligjor do ta formon një kompani komunale, që unë plotësisht e përkrahi këtë ide dhe jam për këtë. Unë po të informoj, se kryetari e ka marr çmimin “Honorigjauza”, ne si kabinet i kryetarit e kemi bë reagimin tonë, ku ki mujt me e lexu ti, i cili ka qenë përmes mjeteve të informimit. Është viti zgjedhor, por duhet të ruhet ajo fryma e demokracisë dhe duhet të ruhet integriteti personal. Ti po thu qe kryetari e ka ble at çmim, unë po të pyes: A e ka ble edhe drejtori i shkollës së Smirës? Nuk po du me përmend këtë, por pa mëdyshje po na shtini me i than edhe këto, ka qen dashur ta lexoni sqarimi që e ka bë kabineti i kryetarit ne mjetet e shkruara, ku janë dhen të gjitha ato informacione. Një pyetje ishte për pyjet, ju tham që për pyjet menaxhon Agjensioni Pyjor i Kosovës. Përpjekjet e tona janë të vazhdueshme, të rritet numri i punëtorëve në atë sektor dhe t’i ruajmë pyjet më mire. Çështja e turizmit është tjetër, varet sa e gjan biznesi veten aty se për me ndërtu fabrikë kurrë nuk e kemi pengu as nuk e pengojmë, por duhet me qenë një vullnet për me zhvillu një biznes. Sejda e shtroj një çështje, ku edhe unë mendoj që ato duhet të largohet prej aty që të kemi një gjendje me të mirë që e kemi aty.

z.Bekim Azizi: Po i them nënkryetarit, mos u ngut me garantu shumë, se shtypi ne Shqipëri çka ka shkru ai ka shkru që është matrapaz, na i kemi interpretu ata, ata kanë tregu që i kanë hulumtu rastet. Edhe te “Higjiena”, edhe ti e din me mirë se je kanë pjesë e Kuvendit edhe ti i ke votu qato, mirë i dine, por ty prej që je në pushtet ty të kanë ndodh, qeto 23 punëtor janë me një kamion tu sill, 27 fshatra menaxhohen me një kamion të mbeturinave se janë shitë tjerët, asnjë pajisje tash nuk është në emër të njësisë së “Eko Higjiena”, krejt vitin që shkoj kane dal në emër atij në Gjilan.

znj.Mirlinda Sadiku: Një peticion mu ka afrua prej qytetarëve, të cilët janë të shqetësuar për pronat e tyre, për jetën e tyre, se po dëmtohen edhe shpitë e tyre. Sa hera e parë që kam paraqitur peticion, kam paraqitur edhe për fshatin Beguncë me 222 nënshkrime, po ky është shqetësim i

qytetarëve, ata e kane përcjell vijën institucionale, tek e fundit kjo është një detyrë e këshilltarit, që duhet me kry para bashkëfshatarëve të vete e pare te gjithë qytetarëve të Vitisë, e ma merr mendja shume me kompetentë është drejtori Vetoni me tregu për cilin kanal është ne pyetje, se ti nënkryetar e ngatërrove me at kanalit tjetër, por te jesh i bindur që ky kanal për të cilën e kam fjalën unë nuk është i hapur.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetjet për te gjithë! Unë i kam dy shqetësime, ka kohë që ky Kuvend ka bërë emërime të rrugëve pavarësisht që nuk jam pajtë me to. Po ka kërkesa, ankesa të qytetarëve, d.m.th sot e asaj dite nuk kanë përgjigje. Po më intereson, pse nuk është mbledh komisioni me i shqyrtu këto. Një çështje tjetër, ky kuvend ka kërku dhe ka insistu, që Vitia të këtë kyqje në autostradë, ku kemi kërku takim me ministrin e kryeministrin. Takimi me ministrin është bërë, me kryeministrin nuk është bërë, për këtë deklarimin e fundi që do ta shqyrtojmë këtë mundësi, unë mendoj që kjo çështje mund të na sjell probleme, tu i pas parasysh se shqetësimet e qytetarëve të Vitisë janë tash me te mëdha, sepse punët janë afër rreth asaj nyje, veç fillon puna aty dhe përfundimisht ma nuk kemi çka me bisedu për atë kyqje. Prandaj duhet ta kemi një takim, e qeveria e Kosovës duhet ta ketë një vendim për formimin e kësaj nyje, aty nëse ka vendim, neve nuk na intereson buxheti, se buxheti për autostradën është fiks i ndamë, 600 e 50 milion euro, nëse ka nevojë për shtesë për buxhet, qeveria në vitin tjetër ka obligim sipas vendimit që merr për kyqjen e re që bëhet. Në këtë aspekt mendoj, që ne duhet te kërkojmë prej institucioneve.

z.Ekrem Abazi: Daut, te ishim kanë të Drenicës apo te Dukagjinit, kishim pas kyqje ku kishim deshtë na, po jemi të Vitisë e te Anamoravës nuk na nje kërku. Sa i përket kësaj për çmimin e kryetari, këtë televizion e përcjellin qytetarët e Vitisë, qekjo pune a është informatë apo dezinformatë.

z.Bislim Bislimi: Ne e dimë që pyjet i menaxhon shteti, po kompetencat që ju janë dhënë komunës, mirëmbajtja, rregullimi në atë kuadër ka mundësi mu gjete vende të punës.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Te kanali ne Skifteraj, e dimë mirë se shumë herë e kame hec në kam, ne rast që e ki fjalën për ky që lidhet prej rrugës e del në kanal, është çështje tjetër kanalet që po ti them unë janë të hapura. Bekim, unë nuk e mbroj me fanatizëm edhe nuk jam tu garantu që është e vërtetë, po nuk bi pre e spekulimeve, ka than filon gazeta. Ne e kemi dokumentacionin që na është sugjeru, që vepron dikune 15 shtete, mu kane ilegale moti ishin burgose. Gjatë mandatit tone si këshilltar të Kuvendi Komunal, po te njoftoj, ne kemi marr vendim që ka qenë vendim kundër ligjore e që un kame votu kundër që me e pavarësu. Atë kohë “Eko Higjiena” dhe masanej kurrë asnjë vendim tjetër nuk e kemi marr, këtë ta dëshmojmë, desh thirrë kryetarin e komunës kur dushe bisedojmë, ti e din që e kemi prur një vendim, unë jav kame propozu për një anëtar të bordit.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë, pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e dyte të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2016.
3. Propozim vendim për rritjen e buxhetit komunal nga te hyrat vetanake komunale të vitit 2016.
4. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të Integritetit 2017-2020.
5. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e raportit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2016.

6. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit të punës të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2017.**
7. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e planit të punës të komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2017.**
8. **Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e vendimit për rregullimin e komunikacionit në Qytetin e Vitisë dhe territorin e saj.**
9. **Informatë për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2016/2017.**

Para se ta qes për miratim rendin e ditës, unë e kisha propozu që këtë piken e 8 te rendit te ditës, ta terjekum për seancës e radhës, sepse debatin i cili është mbajtur me datën 16, ku kame qenë prezent edhe unë edhe nënkryetari e ku ka pas prezent një numër të qytetarëve dhe i taksistëve dha janë dhënë disa propozime dhe sugjerime e me insistimin e grupeve punuese na kane sugjeru që ta terjekum për seancën e radhës në mënyrë që të ju mbetet hapësirë dhe kohë të gjitha ato vërejtje e propozime që t'i inkorporojnë. A jeni të mendimi që kjo pikë e rendit të ditës të jeket nga rendi i ditës së sotit, ju lutem me ngritje dore? Konstatoj që me vota të gjithëve u terjek, ndërsa tash e qes në votim rendin e ditës: Kush është që të miratohet ky rendi i ditës me këto pika. Nga të gjithë të pranishmit u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim?

znj.Mirlinda Sadiku: Mu ma merr mendja, që ky procesverbal nuk i pasqyron të gjitha fjalimet qoftë i imi qoftë i disa kolegëve dhe si i tillë ka shumë mangësi, duhet të intervenohet. Në faqen 15, momentin kur ju ka dhen fjala z.Dautit, ai ka thanë fjalë dhe nuk e keni shti këtu, gjithëashtu edhe disa fjalë të kryetarit nuk i keni shti në këtë procesverbal.

z.Daut Xhemajli: Na për herë po i thajmë procesverbal. Procesverbali është shkurtimisht përshkrim i asaj çka muajna me thanë na si këshilltar eventualisht, kush do prej këshilltarëve me e thanë fjalën e saktë e shkruan edhe ja dorëzon procesmbajtësit, për ndryshe qyshe po kërkojmë na ajo është transkript i mbledhjes dhe nuk ka kuptim mu kanë, edhe kjo që është shkru për mu është e tepërt, edhe konsideroj që procesmbajtësi ndoshta është momenti me fillu me ndryshu qasjen ndaj kësaj pune, me shkru thelbin e asaj që u than.

Kryesuesi z.Naim Pira: E hedh në votim procesverbalin, me një vot kundër u miratua procesverbali.

Pika e dytë

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2016.

Drejtori i financave z.Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Duke u bazuar në ligjet e aplikuara në Republikën e Kosovës, Drejtoria për Financa, në çdo tre muaj për gjatë vitit fiskal ka për detyrë të paraqes para Bordin të Drejtorëve, KPF-së dhe Kuvendit Komunal ekzekutimin e buxhetit çdo tre muaj përmes pasqyrave financiare. Para juve i keni pasqyrat për periudhën Janar-Dhjetor të 2016, pra, shifet shpenzimi i buxhetit me të gjitha parametrat dhe strukturën e tij, që është përcaktu në baze të buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal në vitin 2015 për vitin 2016. Saktësisht, buxheti i aprovuar për vitin 2016 ka qenë 10 milion e 176 mijë euro, buxheti i alukum për shpenzim për vitin 2016 janë 10 milion e 6500 mijë euro, kurse mjete të shpenzuara ka qenë 9.997.116 euro, pra, total ky është buxheti i shpenzuar në vitin 2016. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pike të rendit të ditës.

znj. Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për ju të pranishmit! Sot kemi pasqyrat financiare për periudhën Janar-Dhjetor 2016. Në këtë raport i kemi të paraqitur tri kategori ekonomike, që janë shpenzimet, të hyrat dhe investimet. Sa i përket të hyrave, është për tu vlerësuar puna e gjithë drejtorive, pasi që në bazë të këtij raporti kemi inkasim të të hyrave për 101.60%, ndërsa në krahasim me vitin 2015 ka edhe rritje për 22.13%, që flet për një qeveri të përgjegjshme. Njëjtë flet edhe raporti i shpenzimeve, ku ekzekutimi i buxhetit është në përqindje 99.33% dhe tregon për një planifikim të drejt dhe shpenzim të përgjegjshëm të parasë publike. Sa i përket investimeve kapitale, përpos që realizimi ka qenë 99.99%, është për tu vlerësua edhe puna në teren, ku janë bërë investime po thuajse në çdo fshat të Komunës së Vitisë, sikurse në qytet brenda, duke intervenuar në të gjitha ato lokacione që kanë paraqitur kërkesa për investime gjate dëgjimeve buxhetore si dhe duke respektua prioritetet të caktuara nga vet qytetarët, gjithashtu përpos në infrastrukturë është intervenuar në të gjitha sektorët, si ne Bujqësi, Kulturë, Arsim, Shëndetësi, që kanë ndiku edhe në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë.

z.Samet Idrizi: I nderuar kryesues, te nderuar të pranishëm! Kemi para vete pasqyrat financiare vjetore të vitin 2016. Unë kam disa shqetësime në rritjen e shpenzimeve në disa sektor, faqe nr. 3 shpenzimet e udhëtimit brenda vendit dhe jashtë vendit, kanë pas një rritje, është mirë me pas një sqarim, si pasoj e qkafit janë bërë këto rritje. Te shpenzimet e ujit dhe mbeturinave, ka një rritje të telefonisë fikse. Në vitin 2015 kanë qenë 5 mijë e 858, ndërsa këtë vit janë 11 mijë e 902 euro, edhe pse kemi një rreth në valë, e ku edhe aty janë rrit shpenzimet. Është mirë ne me dhënë sqarime pse kjo rritje. Te shpenzimet kontraktuese tjera, na e kemi përmend shpesh shërbimet kontraktuese tjera janë 117 mijë euro e 590 janë të mëdha dhe mu difinu më qartë për çka janë. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, edhe për kundër që kemi ble vetura të reja duhet mu ul shpenzimet e mirëmbajtjes. Ne këtu kemi një rritje, të investimet kapitale te raporti që e ka dhënë kryetari ndoshta disa te dhëna këtu nuk përfshijnë kur e ka prezantim për investimet kapitale kanë qenë shuma shumë më të mdhaja se investimet që prezantohen këtu. Te pasqura financiare vjetore, investimet kapitale me të mdhaja kanë qenë në 2015 se sa 2016. Te shkalla e realizimit vjetor, e inkasimit është 101%, prej 60 unë mendoj që kjo ka qenë dashur të jetë dikun 150%. Shkaku se kemi pas një amvisti të gjatë të faljes së borgjeve publike, ku realisht na e dimë që nuk është ky inkasim real, se na e dimë qysh ka qenë 2015. Na e dimë që vitin e kaluar planifikimet që janë bërë për me arrit në spektorë të ndryshëm veç e veç janë ulur pak koeficientet, e kemi rastin p.sh.: te tatimi ne pronë, na kemi planifiku me ultë me e realizu 2016 se sa 2015, kështu që unë mendoj që nuk ka qenë edhe shumë pasi që janë ulur koeficientet e targetit për mu arrit me letë edhe janë arrit edhe për qeta përqindjet kanë dal shumë me të mëdha, se sektorit i inspektoriatit. Mendoj që duhet me punu me shumë dhe ka vende për me shqiptu gjoba më shumë, sidomos te ndotja e ambientit, te mbeturinat.

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtor, ne në komitet u dakorduam, që të na sjellët edhe një listë për investimet që janë ekzklusivisht të komunës me bashkëfinancim dhe prej qeverisë, po ndoshta nuk ki pas kohë. Tek Zyra e Kryetarit, tek shifra 134460 është një shumë prej 14 mijë e 299 euro, d.m.th janë shërbime kontraktuese nga Zyra e Kryetarit, më intereson ta di, se çka ka kontraktu Zyra e Kryetarit që ka pas nevojë për këtë kontratë, pse nuk janë da subvencionet që janë në kuadër të Zyrës së Kryetarit, që kanë të bëjnë me bursat e studentëve. Me sa kam informacione, komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve është mbledh qyshe para vitit të ri, ndërsa hala sot ne muajin shkurt bursat ende nuk janë nda. Është shqetësues fakti që Komuna vazhdon të humb procese gjyqësore, kodi 134460 na tregon, se komuna është dash ti pagun 13 mijë e 662 euro, është evidente se komuna ka shpenzu 100 mijë e 867 euro, mirëpo ka pas ankesa të shumta për mirëmbajtjen e

rrugëve, e keni pa, e kam paraqit edhe me foto, ku kombibuzi i personave me aftësi të kufizuara, për shkak të kushteve të këqija, ka pas akull në rrugë, ka pësua aksident edhe janë shqetësu ata fëmij që janë qenë aty. Është fakt rritja e të hyrave vetanake, duhet të na gëzoj të gjithëve, sepse kjo do të na kthehet në formë të investimeve në kapitale, duke ju falënderu edhe faljes së borgjeve, mirëpo është shqetësues fakti, që e potencoj edhe drejtori, që nuk janë arkëtu, mbesin pezull borxhet e qytetarëve, tatimi në prone 1 milion e 592 mijë e 276 euro, me të vërtetë është shqetësuese, qiraja nga hapësirat publike dikun 15 mijë e 355 euro. Komuna duhet të cakton si prioritet, sepse ka shumë persona të cilët e shfrytëzojnë hapësirat publike dhe kanë obligim nëse e shfrytëzoj atë hapësirë të paguajnë taks. Sa i përket projekteve kapitale, sidomos të shtrimit të rrugëve me asfalt, është evident fakti se shumë rrugë të cilat janë shtrur kanë plasaritje, nuk kanë bazë të mirë, ka pa përkufizime anësoret edhe kjo komunë ka paguar 12 mijë e 303 euro kompanive, dy kompanive që të bëjnë mbikëqyrjen e projekteve edhe projektet nuk po kryhet me kualitet të mirë dhe cilësor, që t'i rezistoj kohës. Po ashtu është shpenzuar 19 mijë e 33 euro për pajisje trafiku, ku na shumë mirë e dimë me sa me kujtohet a ka qenë muaji mars apo qershor është bërë shënimi i vijave, i zebrave, me vonë është bërë ajo rrugë me asfalt dhe prapë janë shënuar vijat në atë rrugë. Prandaj pse komuna duhet të shpenzoj dy herë para nga buxheti i saj për të bërë shënimin e vijave për një punë, d.m.th kjo është mungesë e një keqplanifikimi, si dhe kodi 14010 mirëmbajtja e veturave që u potencu nga kolegu, që janë shpenzuar 28 mijë e 404 euro. Me sa me kujtohet mu kaq kanë kushtuar edhe golfat e ri që i kemi bërë, pse po prishen, çka po ndodhë me veturat, kemi një shumë të madhe të mirëmbajtjes.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pasqyrat financiare që i kemi para vetes për periudhën janar-dhjetor 2016, me këto pasqyra nga të hyrat që kemi pas të planifikuara, ajo që vlen të përshëndetet, që është bërë një punë e mirë është që kemi rritje të hyrave vetanake. Përqindja është 101.68%, apo nëse e marrim e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit kaluar është më e madhe për 172 mijë e 951 euro. Nëse këtë e kthejmë në përqindje është 22.13%, buxheti i alukuar dhe i shpenzuar në përqindje prej 99,33% na bën të jemi përgjegjës për të gjithë kategorinë që e kanë shpenzuar këtë buxhet, nëse i analizojmë përqindjen e buxhetit neper të gjitha drejtorit, me përjashtim të Zyrës së Kryetarit, që kemi një përqindje me të vogël, e të cilën e shpjegoj drejtori, që është çështja e mos ndarjes së bursave. Në të gjitha drejtoritë buxhetin e kanë shpenzuar mbi 98%, të të hyrat vetanake të planifikuara dhe të realizuara kanë qenë 939.500,00, kurse janë realizuar 954.559 euro, apo marr me shifër 15 mijë 59 euro janë më tepër. Edhe donacionet i kemi në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar me të mëdha 160 e 200 mijë euro me 56 mijë e 700 euro që kanë qenë apo me përqindje 286%. Krejt kjo punë e mirë që është bërë gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 rrumbullakohet me investimet në projektet kapitale, që kur kam thanë vitin e kaluar që të mrrihet qind për qind dikujt ju ka dok e pamundur, po kjo përqindëshi që e kemi këtu, tash që është 99,98%, për mu kjo është qind për qind, dhe në bazë të votimit që e kemi bërë na që jemi pjesë e ligjdhënies dhe të ekzekutivit, përqindja e shpenzuar e këtij buxheti na bënë të mburremi me punën institucionale që e ka bërë kjo qeveri. Në pasqyrat analitike që i ka prezantuar në pasqyra drejtori, duke i hekur projektet e shpenzimet e tjera, që janë bërë për mbikëqyrje, gjatë vitit kalendarik 2016 janë 35 projekte të realizuara në Komunë të Vitisë, që janë në shërbim të qytetarëve të komunës së Vitisë. Prandaj, vetëm i përgëzoj dhe le të vazhdojmë me këtë trend edhe në vitin 2017.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje! Unë i kam disa shqetësime lidhur me pasqyrat, tu e pas parasysh se disa çështje janë të theksime dhe nuk po du me i përsërit. Mu me brengos rritja të shpenzimit kontraktuese që po bëhen në komunë e mendoj që komuna duhet me marr seriozisht këtë punë e mos me leju ose me tentu me zvoglu këtë shumë në vitin e ardhshëm, se me të vërtetë 117 mijë euro është shumë e madhe. Shqetësimi tjetër, më intereson me ditë cilët projekte i ka

paguar Komuna e Vitisë prej buxhetit të vet, cilët janë ato projekte, edhe një çështje kam kërku, që të ju bashkëngjitet këtyre pasqyrave një informatë me shkrim nga drejtoria, cilat janë projektet që janë realizuar në bashkëfinancim me Qeverinë me donatorët e me te tjerë, në formë që ta kem të qartë sa ka paguar Qeveria e Kosovës, sa Komuna për secilin projekt të realizuar për 2016 dhe për palët e treta, sa ka paguar komuna e sa donatorët për projektet që janë realizu në 2016. Mendoj që kemi nevojë me i pa këto.

z.Bekim Azizi: Në KPF diskutuam, që ndriçimin në Smirë, unë thash që është pagu, ti thave është projekt dyvjeçar. Unë i kshyra buxhetin që e kemi pas planifiku për 2016, asnjë vend nuk e kemi asnjë projekt të planifikuar dyvjeçar, d.m.th qekjo bjen sepse nuk u kanë qashtu. Nëse ti e knda me vonë projektin dyvjeçar është çështje tjetër. Për ndriçim publik e për rregullim të troturave i kemi pas nda të planifikume 213 mijë, plus 45 mijë nga te hyrat vetanake që janë kanë të parapamë. Te asfaltet që po bëhen mbi asfaltet, në projekte sa është trashësia e qëtyre asfalteve. Te një raport që e kemi pas muajin e kaluar, te kryetari 6 milion investime, sot po na dalin as 2 milion, nuk e di ku mbeten. Mirë është përqindja që është e shpenzimeve, por me intereson te pjesa faqe 29, krahasimi i shpenzimeve, janë 213 mijë euro janë borxhe që janë pagu vitin e kaluar, na e dimë që hyn në raport të shpenzimeve sa është pagu, mirëpo edhe këtu i ki paraqit disa borxhe që janë, mirëpo në mesin e borxheve që janë kërkun nuk i kemi para pa me një borxhe 40 mijë euro të kanalizimit në Smirë, një borxhe 70 mijë euro te kanalizimit në Terpezë, i kishit do borxhe të shkollës së Sllatinës pa pagu, kishit edhe do obligime të tjera, nuk e di ku figurojnë ato, të kontratat e nënshkruamë vitin e kaluar dikun mbi 60 kontrata, 42 kontrata kanë jashtë kompanive të Vitisë. Të gjitha kompanitë, të gjithat projektet që janë me vlera të mëdha kapitale, që është shqetësuese për mu, te drekat zyrtare, për tri vite e keni bënë lëvizje, vitin e pare keni shku 16 mijë euro, vitin e dyte 22 mijë euro, tash e keni kalu 26 mijë euro, e nuk janë shti as darkat e fundvitit, e kur e kemi parasysh që sivjet është vit zgjedhor, kjo shkon edhe me shumë kjo rritet. Te kontratat mbi vepër, që tri vite i kërkoj me naj bënë një list, ti dimi kush janë, ti dimi saktë, je i obligum me naj pru. Njëfar dëftese e pata kërku në KPF, një pagesë të muajit mars te vitit të kaluar, kompania pastrimi, është bënë pagës për muajin mars 35 ditë, pate me pru qatë dëftesë, besoj që e ki parasysh.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Po ju përgjigjem pyetjeve të parashtruara nga asamblistët. Në fillim ju thash, që faqja e fundit e tabelës në pasqyra paraqet krahasimin e shpenzimeve për vitin 2015-2016, edhe tash që janë dy buxhete 2015, ka pas buxhet të veçantë 2016, buxhet të veçantë që është miratu nga ju. Ju kemi përmbajt të gjitha planifikimeve buxhetore, fq.29 e 30, ku krahasohen shpenzimet shifet që 28 mijë e 595 euro kemi shpenzime me te vogla se vitin 2015. Të gjitha që u than nga ju si sugjerime, i pranoj për mu planifiku në të ardhmen me drejtë, por jo për naj gjykim për me ni veten keq si drejtori e si pasqyra financiare. Kontratat mbi vepër, pozicioni të cilin vazhdimisht këto pyetje kanë qenë edhe në KPF. Na për hir të sinqeritetit jemi mundu me sqaru, kontratat mbi vepër, nuk e kapin shumen që është paraqitur në pasqyrat financiare 117 mijë e 590 euro, por janë 42 mijë e 42 euro, se ne kuadër te këtij kodi nuk ka pas mundësi në vitin 2016 me e pas shume kode edhe pse në vitin 2017 e kemi. Në kuadër të këtij kodi ku janë edhe kontratat mbi vepër, ka edhe shpenzime të tjera, tu fillu me pagat e Grosborderit, aktivitetet të tjera, a nga kjo shume vetëm 42 mijë e 42 euro janë për kontrata mbi shërbime te veçanta. Obligimet e pa treguara ke pyetje. Të gjitha obligimet që kanë vlerë juridike dhe financiare janë obligime që kanë dokument mbrapa edhe të gjitha ato obligime financiare që kane mbështetje juridike e financiare i kemi paraqit në tabelën e fundit faqe nr. 30, ku janë 169 mijë euro, qato jane obligime reale të cilat i kemi në shërbimin e financave dhe ato janë të paraqitura, ndërsa për pjesën e kanalizimit për Tërpezën e për Smirën, ku janë 70 mijë në Tërpezë edhe 40 mijë në Smirë, ato obligime mundesh ti me i qujt, por përderisa nuk marrin formën juridike dokumentacioni a janë kry punët a janë

formu, na jemi në vazhdimësi të këtyre me i realizu, ku është formu komisioni për pranimin teknik dhe kanë me u vërtetu të gjitha punët për këto dy projekte. Në qoftëse dikush i konsideron të patregume, atëherë është joprofesionalizëm në kuptimin ekonomik, por përndryshe kur ta marrin anën zyrtare juridike, na e kemi për detyrë me e paraqit në pasqyra si obligim për pagesë. Trashësia e asfalteve, po kjo sipas projekteve, kemi shume projekte, disa projekte e kanë 7 cm, disa 5 cm, në baza të projekteve. Ndriçimi publik në Smirë, kjo qind për qind është projekt dyvjeçar, planifikimi ka qenë 40 mijë euro, por gjatë ekzekutimit dhe gjatë kërkesave që i kemi thith, tu e përgatit projektin, na ka dal më shumë projekti se sa që kemi pas buxhet. Na atë punë e kemi tenderu dhe për hirë të mungesës financiare e kemi parapa projekt dyvjeçar, ku edhe ligji naj mundëson. Janë edhe kanalizimet, trotualet e ndriçimi publik, projekt dyvjeçar. Jam tu e përgatitë listën e projekteve nga Qeveria e nga donatorët, do ta keni këtë listë. Te kualitetit i projekteve, nuk jam ekspert me dhënë vlerësim, po ne i kemi operatorin ekonomik dhe menaxherin e projekteve, që është në kuadër të Zyrës së Kryetarit dhe ato janë dy hallka kryesore për këtë çështje. Rritje të telefonat fiks, udhëtimet jashtë vendit ke një pyetje, nuk janë më shumë as shpenzimet e udhëtimi, as telefonia, as mbeturinat. Unë e këqyra tash, nuk janë më shumë janë, afërsisht me vitin 2015 janë planifiku kaq edhe kaq janë shpenzu.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Te çështja e bursave, është një realitet, se komisioni është formu para vitit të ri, i cili komision ka punu edhe dje e kemi pas një takim. Krejt vonesa ka ndodhe se është një kategori shumë e ndjeshme, prandaj po duhet në përpunje me konkursin që e ka shpall DKA-ja, për shkak se do të eliminohet ata të cilët janë bursista të universiteteve dhe hala nuk e kemi atë informacion. Ata që fitojnë bursa universitare nuk do të fitojnë edhe bursa komunale, për këtë arsye nuk i kemi publiku ende bursat. Çështja e gollfave, jo nuk i kemi ble të ri, se mi pas ble të ri do të ishin më mirë, po i kemi ble të vjetër. Janë rrit numri i automjeteve edhe të zjarrfikësit krejt bëjnë pjesë edhe të shëndetësia janë rrit automjetet. Te zebat ishte një pyetje, projekti Stubëll dhe disa lagje në lokalitete, kanë qenë projekte dyvjeçare nga ana e ministrisë, dhe kemi arrit në bashkëpunim me ministri që na duhet me intervenu te shenjat horizontale e shenja të komunikacionit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi kemi koorem të mjaftueshëm, vazhdojmë me pjesën e dytë të seancës

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim vendim për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2016

Prapë e ftoi drejtorin e Financave që ta merr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z. Ibrahim Rama: Të nderuar këshilltar komunal, bazuar në nenin 58, shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, statutin e Komunës së Vitisë, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë Propozim vendim për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2016. Për mos me ju marr kohë ma shumë, propozim vendimin e keni para vete, për pyetje apo ndonjë shpjegim jam këtu për të ju ndihmuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit drejtor! Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtor, propozoj në aspektin ligjor, ju mund ta thoni fjalën tuaj, pasi që sot është edhe pikë e rendit të ditës edhe aprovimi i planit të punës për personat me aftësi të kufizuar, nëse ka mundësi që prej kësaj shume të ju ndahet një buxhet prej një mijë euro po them këtë nëse në aspektin ligjor është në rregull, ju e dini ma mirë, sepse sipas planit të punës që na i kanë dërguar këta, kërkojnë printer edhe fotokopje që këto të dyja bashkë mund me kushtua 400 euro si dhe një ekskursion për këta persona, të cilët janë me aftësi të kufizuar, diku në vlerë prej

600 euro. Do të ishte mirë nëse do të kalonte ky propozim, sepse na po e shohim, se plani i punës së tyre nuk ka kurrfarë mbështetje financiare. Tek e fundit, ky komitet është formuar nga Kuvendi, prandaj do të ishte mirë të paktën një shumë simbolike prej një mijë euro ta përkrahim këtë komitet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Dikush tjetër a ka me diskutua rreth kësaj pike të rendit të ditës? Nëse nuk ka, atëherë drejtor, ishte një propozim i Mirlindës: A mund ta inkorporojmë këtu a jo në aspektin ligjor?

z.Ibrahim Rama: Dokumentet të ndryshme që i miraton Kuvendi apo organet e qeverisë përmes Kuvendit, por kur është fjala gjithnjë për buxhetin e vitit 2016, d.m.th në kodet e planifikuara që i kemi në buxhet të vitit 2016, buxheti i vitit 2017 është tjetër send, pra, na këto pare nuk guxojmë me i shti në buxhet të vitit 2017, që janë paraparë me këto rregullore dhe propozimet që janë të planifikuara nga trupat e Kuvendit Komunal dhe të qeverisë, pra, kjo është për vitin 2016 edhe duhet me u kanë kështu.

Kryesuesi: Pasi nuk ka tjerë për diskutim, e hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatoj se me një abstenim u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë katërt e rendit të ditës kemi:

4. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e planit të integritetit për vitin 2017 - 2020

Ka qenë një pikë e rendit të ditës që e kemi shtyer për këtë seancë për shkak të korrigjimeve që i kemi bërë së bashku me UNDP-në, është punuar dhe na i kanë sjell para kuvendarëve, besoj se materialin e keni marrë me kohë, keni pas mundësi ta shfletoni, por sidoqoftë unë po ja jap fjalën nënkryetarit të flas rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë nuk do të ju marr shumë kohë, për shkak se kemi të bëjmë me një dokument shumë voluminoz. Ju e dini siç e tha edhe kryesuesi, se ka qenë një propozim në seancën e kaluar, një draft plan i integritetit, i punuar kryesisht nga grupi punuese, të cilën grup e ka formuar kryetari i Komunës me një vendim, dhe UNDP-ja megjithatë ka pas vërejtje edhe në KPF edhe në Kuvend dhe serish grupi punues u ndal dhe e ka bërë një analizim të gjendjes dhe një përmirësim të draft planit dhe ja ka dërguar UNDP-së dhe ata janë pajtuar me korrigjimet të cilat janë bërë, dhe prandaj unë nuk do të ju marrë kohë ma shumë, nëse keni diçka, ne jemi këtu për të ju ndihmuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit nënkryetar! Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë dikush fjalën ju lutem?

z.Samet Idrizi: Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e planit të integritetit për vitin 2017 – 2020. Unë po e shohë se shpesh po sjellni materiale, për mua pak voluminoz materiali. Sa i përket lëndës, këtu qe e pash unë një synim shumë i mirë, mirëpo po mungon vullneti politik edhe në qendër edhe nivelin lokal të komunave. Te faqe 4, plani rithekson përkushtimin e Komunës për me i shtua më tej kontrollin ekzistues operativ në të gjithë gamën e aktivitetit të kryer në fokus në ofrimin e shërbimeve transparente dhe efikase me klientin. Ndoshta këtu është mirë me qenë me qytetarin jo me klientin, dhe tjetra, unë pash që është një mundësi shumë e mirë, po ma shumë teori me i shërby edhe qytetarit edhe me ngrit çështjen e shërbimit ndaj qytetarit, pastaj me bërë shmangien ndaj dukurive negative. Çka mund të ndodhë prej vetë zyrtarëve komunal, aty është mirë ndoshta me u themelua një mekanizëm tu bazua në këtë plan të integritetit edhe mekanizimin që bëhet perime me punua në të mirë të këtij plani edhe me arrit diçka e jo vetëm me mbet dokument në letër

Kryesuesi z.Naim Pira: Ndoshta një sqarim për këtë plan të integritetit. Është mbajtur një punëtori dy ditore e organizuar nga OSBE-ja, që prezent kemi qenë edhe ne si Kuvend Komunal dhe po ju them me sinjoretin ma të madh, se drejtoritë të cilat kanë qenë prezentë, ligjëruesja e

atij trajnimi i ka vlerësuar me notën ma të lartë të mundshme. Nëse nuk ka dikush tjetër rreth këtij plani, unë e kisha qitë në votim për miratim: Kush është që të miratohet ky plan i integritetit. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi

5. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e raportit të punës të komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale për periudhën janar – dhjetor 2016

Ja kisha kalu fjalën kryesueses së këtij grupi, që në pika te shkurtra të paraqes para juve.

znj.Xhylsime Qamili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në pika të shkurta do të raportoj për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2016, për punën e Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky komitet përbehet prej 5 anëtarëve 1. Xhilsime Qamili – LDK, 2. Taip Alidema -PDK, 3. Mirlinda Sadiku -AAK, 4. Vjollca Sylejmani -AKR, 5. Abide Osmani - Shoqeria Civile. Do t'i falënderoja për përkushtimin dhe punën që e kanë bërë për angazhimin në këtë komitet, andaj është arrit një marrëveshje që i ka kushtu për së mbari kësaj komune. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka për detyrë që të shqyrtoj çështjet te cilat kanë të bëjnë me gjendjen në Shëndetësi dhe gjendjen sociale të banoreve të Komunës se Vitisë dhe te jep vërejtje, propozime dhe rekomandime për tejkalimin e gjendjes në Shëndetësi, andaj ky komitet e ka filluar punën duke u përqendruar në këto dy shtylla 1. Hartimin e planit te veprimtari te Komisionit për Shëndetësi, 2. Analizën e gjendjes se politikave publike të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur dy takime te rregullta pune me anëtarët e Komitetit, si dhe janë kryer disa vizita nëpër institucione shëndetësore, strukturave udhëheqëse dhe personelin shëndetësor në Komunën tonë, si dhe spitalin rajonal në Gjilan dhe Kamenicë. Kjo e Kamenicës ka rezultuar me atë se janë marr edhe masa, kemi pa për se afërmi se si funksionon një shtëpi e komunitetit për persona me aftësi të kufizuar, çka më vonë do ta paraqes edhe si rekomandim që ka dal nga ky komitet. Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, në bazë të të gjeturave dhe takimeve që kemi pasur me stafin e Qendrës së Shëndetit Mendore ne Gjilan, ne takimin e fundit te mbajtur me 25.05.2016, arriti një marrëveshje ne mes të QKMF-së me Qendrën e Shëndetit Mendore ne Gjilan. Kjo ka rezultuar pozitivisht, që sot e kam informatën që i kam marr edhe shënimet që gëzohemi nga ajo, se kjo marrëveshje ka informu qytetarët dhe ka ndiku që këta persona të barten nga stafi, dhe transporti i këtyre personave te behet pikërisht nga Qendra e Shëndetit Mendor. Andaj, ky komunitet doli me rekomandimet si ne vijime: 1.Te shikohet mundësia financiare, që të mundësohet hapja e një shtëpie të komunitetit për personat me aftësi te kufizuara mendore, e cila do te shërbente në masë të madhe në risocializimin e kësaj shtrese të shoqërisë, gjithmonë duke u bazuar në financat dhe bashkëpunimin e Ministrisë së Punese dhe Mirëqenies Sociale, 2. Vizita sistematike shëndetësore nxënëseve të komunës sonë, te cilat vizita do ti kontribuojnë shëndetit dhe zbulimin e hershem te anomalive te tek nxënësit. Po e shihni që i përmenda financat, ne e dimë buxhetin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, por edhe të Komunës, atëherë jemi rezervu dhe nuk kemi dal me një projekt gjatë këtij vitit 2017, edhe pse kjo është një nevojë. Në rast se doni një sqarim çka është shtëpia e komunitetit dhe çka është qendra e shëndetit mendor ju jap sqarim, se nuk janë të njëjta. Shtëpia e komunitetit është shtëpi rezidente, që qëndrojnë pacientë, personeli me vite të tëra, kurse te qendra e shëndetit mendore qëndrojnë një javë, dhjetë ditë, kështu që lëvizin pacientët, për ketë arsye ne jemi duke punuar ne hartimin e një projekti për një shtëpi të komunitetit ne komunën tonë, me ata të cilët shihet me Ligjin mbi Shërbimet Sociale dhe familjare Nr.02/L-17, si dhe duke u mbështetur në udhëzimin administrativ të Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies Sociale Nr 11/2014, për punën dhe kriteret për vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuar mendore, ngecjen ne zhvillimin mendore, ku parashihet edhe komunat të kenë

një shtëpi të tillë. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit doktorëshë, unë po e hapi debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta marr fjalën dikush ju lutëm?

z.Bislim Bislimaj: Ne si komunë e kemi obligim ligjor të përkujdesemi për këtë kategori të këtyre njerëzve, meqenëse edhe numri i popullsisë qysh kanë dalë statistikat është shumë i madh, unë nuk kisha thanë vetëm për ata se kanë mangësi mendore, por edhe për tjerë persona me aftësi të kufizuara. Është mirë me u konsultua edhe nga qendra çka mundet me bë ajo për me bë një qendër siç e tha doktoresha edhe t'i sistemojmë ose përkohësisht ose të paktën kohen ditore ta kalojnë aty.

Kryesuesi: Dikush tjetër a donë me marr fjalën? Nëse nuk ka, unë po e qes në votim që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e planit të punës të komitetit për shendetësi dhe mirëqenje sociale për vitin 2016

Fjala për ju drejtoresh.

znj. Xhylsime Qamili: Unë nuk kam qas me shtu ma shumë, vetëm një informim, që në hartimin e planit të punës të Komitetit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për vitin 2017, kontribut të madh dhanë anëtarët e këtij komiteti, çka edhe i falënderoj, ku ky plan është i orientuar në katër shtylla kryesore, në të cilat shtylla paraqitet qëllimi, objektivi, aktiviteti dhe koha e mbajtjes së këtyre takimeve. Atëherë unë nuk kisha me zgjat ma shumë, për pyetje apo ndonjë konsultim jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit doktorësh! Hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë me marr fjalën dikush ju lutëm? Pasi që nuk ka e hedhin në votim këtë pikë të rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi

7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e planit të punës Komitetit Konsultativ për Përsosjen me Aftësi të Kufizuara për vitin 2017

Ky është një komitet konsultativ, të cilin e ka formuar Kuvendi Komunal në vitin 2014, janë përzgjedhë anëtarët e këtij komiteti dhe ata janë duke e bërë punën e vetë aq sa kanë mundësi, me që na i kanë sjellë një propozim vendim për një aprovim të planit të punës. Materialin e keni marrë me kohë, kryetari i këtij komiteti gjendjen shëndetësore nuk e ka mirë dhe nuk ka mund të marrë pjesë në këtë seancë. Unë po e hapi debatin, nëse ka dikush me thanë diçka rreth këtij plani: A ka dikush? Nëse nuk ka, unë po e qesë në votim për miratim: Kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se me vota unanime u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

8. Informatë për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor të vitit 2016-2017

z. Qahil Sinani: Kjo informatë është përfundim i gjysmëvjetorit të parë, megjithëse jemi në muajin shkurt, po rendi po e donë ashtu me prurje si informatë edhe e kemi sjellë. Unë nuk do të ju marrë ma shumë kohë, informatën e keni marrë me kohë, për ndonjë konsultim jam këtu së bashku për të diskutuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta marr fjalën dikush ju lutëm?

znj. Mirlinda Sadiku: Vet fakti që i ke ma shumë se 800 punëtorë nën menaxhim, ajo është problematike dhe ke sfida shumë dhe ka çka me u fol shumë. Drejtor, më intereson të dimë gjithë rezultatit e PIS-ës, si masë strategjisë nacionale, që është aprovua edhe në Parlamentin e Kosovës, që është propozua prej ministri. Aty parashihet në strategji 2017-2022, të caktohen edhe koordinator të cilësisë: A është punuar në këtë drejtim? Kam parë që ke marr pjesë në mbledhje aty me ministrin: A ka fillua me u implementu, a është tu mendua me punua në atë drejtim? E dimë se rezultatet kanë qenë nën mesataren. Drejtor, shkolla mesme profesionale ka qenë shkollë bujqësore edhe në pronësi të saj është edhe një parcelë toke, e cila gjendet afër tregut: A është punuar diçka në atë drejtim që të jetë ajo në dispozicion, pse jo edhe të gjenerohen të ardhura drejtor, pse nuk po mendohet në rifunksionalizimin e sallës së edukatës fizike, që është aneks i shkollës së vjetër? E dimë se gjimnazi gjatë kohës me diell mund me mbajt orën e edukatës fizike jashtë, por gjatë të reshurave atmosferike ata rrinë brenda. Sipas një kalkulimi që kemi bërë para 4 viteve me 5 mijë euro ajo sallë funksionalizimet. E pash se tash së fundmi era e ka dëmtuar edhe kulmin, Drejtor, më intereson ta di, unë e kam prezantuar një dokument, besoj se të ka ardhur edhe në zyrën tuaj nga Drejtoria e Inspeksionit, e ke pa vetë edhe cilësinë e ujit nëpër shkolla, ka prezencë edhe të baktereve dhe me elemente kimiko fizike: Çka do të ndërmerr drejtoria e juaj? Sa i përket bursave vetëm se e dha një përgjigje nënkryetari, po ashtu drejtor pse gjimnazi ka nevojë për dy sekretar. Pyetje: |A është bërë ndonjëherë dezinfektimi i çerdhes, pse nuk është hapur konkursi te Kuvendi i Lezhës, kur e dimë se sipas ligjit dhe sipas udhëzimit administrativ, 3 muaj para se t'i skadoj mandati drejtorit duhet të hapet konkursi si dhe a është problem i zgjidhur afatgjatë uji në shkollën e Beguncës.

z.Vehbi Rama: Edhe pse nuk dashta me dal me fol, por e pash një kontrast shumë të madh suksesi i matjes për shkollat fillore 84.6%, ndërsa për shkollat e mesme 53.3%, qeta nxënës të shkollës fillore shkojnë edhe në shkollën e mesme, po më duket diferencë e madhe, po ndoshta tu rritë nxënësit tu qoroditë, nuk po e di. Sa i përket muajit shkurt, ka pas shumë ngjarje në këtë muaj, bile ma herët e kam quajtur shkurti, muaji i minatorëve, që ka sakrifikuar njerëz para 28 viteve për me ardh deri te çlirimi sot i Kosovës. Pastaj, pas shkurtit vjen marsi 8 marsi, që uroj ditën e grave, 7 marsi dita e mësuesit, që dua të ndalem këtu pak ma tepër për 7 mars, ndonjë koktej si zakonisht ju qeveria që i jepni mësueseve, por kisha me bë një propozim shtesë. Gjatë luftës dhe para lufte, këta mësues kanë dhënë mësim nëpër shtëpia shkolla edhe mos të harrojmë të kaluarën e tyre që është mirë me i ftua apo edhe me ju dhanë ndonjë mirënjohje, sepse nuk janë më shumë se 22 shtëpia, kanë qenë shkolla e me ju dhanë nga një mirënjohje.

z.Bekim Azizi: Unë shumë shkurt, se na kemi diskutuar edhe në KPF, kisha dashtë me ditë sa shkolla janë me ushtrues detyre apo pa drejtor, dhe isha lidh edhe njëherë drejtor, çështja e gjetjes së mundësisë për praktiken profesionale për material, d.m.th kjo të merret shumë seriozisht, të furnizohen me material harxhues për punë praktike. Ky është problemi kryesor te shkolla teknike, që është te mësimi praktik.

Kryesuesi z.Naim Pira: Dikush tjetër a ka me diskutua? Nëse nuk ka, unë po konsideroj se vërtetë propozimi i Vebiut ishte jashtëzakonisht me vend, ku propozoj që atyre njerëzve që kanë lëshuar shtëpitë për shkolla, ishte shumë i mirë, edhe po besoj se Drejtoria e Arsimit do ta merr shumë seriozisht këtë. Edhe kërkesa e Bekimit me u furnizua me material për çështjen praktike, konsideroj me vend, po Mirlinda i parashtroj edhe një numër të pyetjeve, besoj se drejtori i ka evidentuar edhe do të na jep përgjigje aty ku ka mundësi.

z.Qahil Sinani: Koordinatorët, është e vërtetë se nga Ministria e Arsimit janë aftësuar dhe janë përgatitur, por po pritët udhëzim administrativë, se një koordinator mbi një mijë nxënës i ka 10 orë ma pak mësim. Koordinatori zgjidhet për dy vite, por vjen prej asaj shkolle janë përgatit gati

për secilën shkollë, po për shkollat që kanë ma pak se 700 nxënës koordinatorit u hekën vetën 4 orë, përndryshe do të jetë efektive koordinatori i asaj shkolle me bind një shok të vetin, si duhet me punu, problem, ma mirë do të ishte që Ministria e Arsimit të hap vende të punës për psikolog. Nëse te na koordinatori është i jashtëm edhe të përcjell ndryshe, punon, ndërsa koordinatorin që e kemi aty edhe përditë në të del në kafe, bashkë rrinë është problem. Të gjitha punët që kryhen në shkollën e mesme teknike janë në kuadër të shkollës edhe në aspektin bujqësor edhe në aspektin teknik edhe profesional tash e kemi marr vendim nëse këto grupe të cilat po ushtrojnë në sallën e edukatës fizike të bisedohet me ta, nëse nxënësit paguajnë patjetër ka me pagua ai që bënë ushtrim. Sallën e vjetër ne e kemi objektiv, kështu në punë për me rivitalizuar krejt shkollën e vjetër, e në kuadër të saj edhe sallën e edukatës fizike, se është e vërtetë se gjimnazi nuk ka sallë dhe është e vërtetë se ajo sallë mund të përdoret. Sa i përket cilësisë së ujit, po ka ndryshime, njëherë nuk banë, mas një muaji cilësia ka dal mirë e ujit. Bursat, ka fol nënkryetari, bahen shumë shpejtë. Te gjimnazi, ishte fjala për drejtorin. Tash me ligjin e ri duhesh patjetër me marr pëlqim për vendin e punës drejtor, nga Administrata Publike për me ta dhënë pëlqimin për shpalljen e drejtorëve të shkollave. Shtëpitë shkolla, është e vërtetë, janë 22 shtëpi shkolla, deri tash janë lënë anash, tash është mirë me ju dhanë ndonjë mirënjohje. Një pyetje te nota mesatare në gjimnaz, është real nota mesatare, se notimi në gjysmëvjetorin është shumë real. Praktika është e vërtetë se është duke u kry në shkollën e vjetër. Harrova me cek se janë nda 48 mijë euro nga Ministria e Infrastrukturës për sallën e edukatës fizike për inventarizimin e saj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë, meqenëse Vehbiu na i rikujtoj që 8 Marsi është Dita Gruas, atëherë unë po e shfrytëzoj rastin që të gjitha nënave, motrave, grave të ju uroj 8 Marsin dhe mirë u pafshim në seancat tjera të radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
